



**Raporti
Vjetor**

2020

Përmbajtja

Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore.

8

Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje dhe kohezion social

14

Krijimi i parakushteve për rritjen e punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit

22

Realizimi i së drejtës në edukim dhe arsim cilësor

31

Ndihma në situatat e fatkeqësive natyrore dhe të konflikteve

43

Buxheti Vjetor

47

Kush jemi ne!

Cartias Kosova është institucion i Kishës Katolike në Kosovë misioni i së cilës është promovimi i paqes, solidaritetit, dhe dashurisë në mes të njerëzve. Caritas Kosova është anëtare e Caritas Internationalis (CI) dhe Caritas Europa (CE) që shërben dhe ofron ndihmë për më të varfërit pa dallim gjinie, race, kombësie, religjioni, etj.

Aktiviteti i Caritas Kosova në vitin 2020, në përputhje me strategjinë, ishte zbatimi i programeve dhe projekteve në kuadër të pesë fushave strategjike:

- Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore;
- Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje dhe kohezion social;
- Krijimi i parakushteve për rritjen e punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit;
- Realizimi i së drejtës në edukim dhe arsim cilësor;
- Ndhimja në situatat e fatkeqësive natyrore dhe të konflikteve.

Nëpërmjet veprimeve të shumta, jemi përpjekur të jemi në afërsi të atyre që janë në nevojë për të lehtësuar problemet në të cilat ata jetojnë, siç janë varfëria dhe izolimi.

Udhëheqja jonë

President i Caritas Kosova është Mons. Dodë Gjergji - Ipeshkëv i Kosovës, ndërsa Drejtor Gjeneral është Don Viktor Sopi.

“Viti 2020 ishte viti i sfidave të mëdha për çdo njeri në botë, së këndejmi u sfidua edhe në që mision kemi shërbimin për njeriun në nevojë, mbrojtjen dhe promovimin e dinjitetit të pacënuar të njeriut. Përballja me pandeminë Covid-19, ishte një mundësi për të gjithë stafin e Caritas Kosova për të rivlerësuar secili në vetëvete, pozicionin e tij karshi familjes, të afërmit dhe njeriut në nevojë, për të rivlerësuar punën e vet misionare, për të ushqyer të varfrit, për tu kujdesur për të sëmurët, për të dhënë ngrohtësi për ata që janë në pikëllim. Mbyllja në pandemi, ishte mundësi reflektimi për të rigjetur forcën dhe kurajon, për të shpërndarë shpresën tek të tjerët se, përkundër sfidës globale dhe rrezikut për jetë, kishte mundësi për të bërë mirë, kishte mundësi për të përkrahur njëri tjetrin, kishte mundësi për të kuptuar sa të cënueshëm jemi të gjithë, pa dallim!” - Don Viktor Sopi.

Të nderuar partnerë dhe miq të Caritas Kosova, në këtë raport vjetor gjeni informacion mbi aktivitetet e zbatuara në mbështetje të personave në nevojë gjatë vitit 2020.

Të dashur bashkëpunëtor të Caritas Kosova



Viti 2020 ishte viti i sfidave të mëdha për çdo njeri në botë, së këndejmi u sfidua edhe në që mision kemi shërbimin për njeriun në nevojë, mbrojtjen dhe promovimin e dinjitetit të pacënuar të njeriut. Përballja me pandeminë Covid-19, ishte një mundësi për të gjithë stafin e Caritas Kosova për të rivlerësuar secili në vetëvete, pozicionin e tij karshi familjes, të afërmit dhe njeriut në nevojë, për të rivlerësuar punën e vet misionare, për të ushqyer të varfrit, për tu kujdesur për të sëmurët, për të dhënë ngrohtësi për ata që janë në pikëllim. Mbyllja në pandemi, ishte mundësi reflektimi për të rigjetur forcën dhe kurajon, për të shpërndarë shpresën tek të tjerët se, përkundër sfidës globale dhe rrezikut për jetë, kishte mundësi për të bërë mirë, kishte mundësi për të përkrahur njëri tjetrin, kishte mundësi për të kuptuar sa të cënueshëm jemi të gjithë, pa dallim!

“Kemi kuptuar se jemi në të njëjtën varkë, të gjithë të brishtë dhe të çorientuar, por në të njëjtën kohë të rëndësishëm dhe të nevojshëm, të gjithë të thirrur për tu rreshtuar së bashku, secili prej nesh në nevojë për të ngushëlluar tjetrin.” Papa Françesku gjatë bekimit Urbi et Orbi, në sheshin bosh të Shën Pjetrit në Vatikan, më 27 mars 2020.

Të udhëzuar nga kjo, Caritas Kosova mbeti e përkushtuar edhe në pandemi, duke mos lënë askënd mbrapa, dhe duke ofruar shërbime anekënd Kosovës. Edhe në pandemi kemi luajtur rolin tonë kyç në përkrahje të personave në nevojë. Këtë e bëmë duke analizuar me kujdes gjendjen sociale dhe ekonomike të qytetarëve dhe duke u munduar të shfrytëzojmë çdo mundësi që na jepet për të qenë në shërbim të tyre.

Viti 2020 vështirësoi në masë të madhe mundësinë e individit që të jetë vetëvetja, të gjejë rrugën e duhur dhe të ndjejë ngrohtësinë dhe kujdesin e merituar, prandaj si Caritas Kosova jemi angazhuar që përmes punës dhe aktivitetit në projektet e shumta që shpalosen në këtë raport, të qëndrojmë sa më afër njërëzve të cilëve iu shërbejmë, dhe tani jo vetëm për tu kujdesur për ta dhe për të ofruar shërbimet, por edhe duke i mbrojtur nga virusi Covid-19.

Pandemia ka ndryshuar përgjithmonë shumë aspekte të jetës sociale, të humanitetit, të komunikimit, të kujdesit dhe ndihmës për të tjerët, mirëpo ishim me fat që partnerët tanë ishin të gatshëm që të mobilizohen dhe së bashku të vazhdojmë përkrahjen tonë për njerëzit në nevojë, që tani, si asnjëherë më parë, kishin edhe më shumë nevojë për një shqetësim të përzemërt dhe për një shërbim profesional.

Jam i lumtur që punonjësit e Caritas Kosova ishin kudo dhe kurdo, duke rrezikuar edhe jetën e tyre, por duke qëndruar në krye të detyrës, pavarësisht izolimit, rrezikut dhe sfidave që kishin kapluar botën. Prandaj, shpreh falenderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë partnerët dhe punonjësit e Caritasit që mundësuan që angazhimi dhe shërbimi ynë të arrijë tek të gjithë ata që kanë nevojë. Po ashtu, bashkëndejmë me të gjithë ata që humbën më të dashurit e tyre nga virusi Covid-19.

Njeriu mund të sfidohet në shumë mënyra, mirëpo kur jemi të bashkuar, sfidat tejkalohen më lehtë, prandaj ju bëjë thirrje që të qëndroni të bashkuar dhe të bashkëndjeni me të afërmin tuaj në çfarëdo situatë!

Zoti ju bekoftë!

Don Viktor Sopi – Drejtor Gjeneral

Fusha strategjike:

Përkujdesi shëndetësor dhe
përmirësimi i qasjes në shërbimet
shëndetësore.



Home Care/Përkujdesi Shtëpiak



Home Care apo projekti i përkujdesit shtëpiak që ka dy komponente kryesore, shërbimet shëndetësore dhe ato sociale për të moshuarit e vetmuar dhe për personat me regjim shtrati është një projekt i veçantë i Caritas Kosova në kuadër të sektorit të Përkujdesit, i cili zbatohet në bashkëpunim dhe bashkë rendim të veçantë me institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky projekt është i hartuar dhe zbatohet në atë mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të grupeve të marginalizuara në Kosovë. Duke parë nga afër situatën e rënduar sociale, shëndetësore dhe ekonomike të personave të sëmurë dhe të moshuar dhe pas identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të çdo individi, kemi ofruar shërbimet sociale dhe shëndetësore në shtëpitë e përfituesve me një bashkëpunim dhe koordinim edhe me institucionet tjera sociale dhe shëndetësore në nivel vendi. Ky bashkërendim, sidomos gjatë vitit 2020 kur tërë bota sfidohej nga Covid-19, ka qenë i domosdoshëm për shkak të specifikave të projektit dhe për shkak të ndërlidhjes së shërbimeve që ofrohen për përfituesit.





Ofrimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore, sipas konceptit Home Care, ka pasur për qëllim që t'iu përgjigjet nevojave më elementare sociale, shëndetësore dhe psikologjike që kishin të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara gjatë këtij viti.

Shumë nga të moshuarit, përfitues të projektit, vazhdojnë të jenë të vetmura dhe të braktisur nga familjarët e tyre dhe nga shoqëria, dhe fatëkeqesisht nuk kanë mbështetje të mjaftueshme për të realizuar jetë dinjitoze.

Projekti Home Care ka ndikuar që jeta, mirëqenia dhe shëndeti i personave të moshuar dhe të vetmuar të përmirësohet si rezultat i ofrimit të kujdesit social dhe shëndetësorë gjatë gjithë vitit. Po ashtu, projekti ka ndikuar që përfituesit e projektit, si dhe familjarët e tyre, të mbrohen nga mundësia e infektimit me Covid-19, duke qenë se shërbimet në fjalë janë ofruar në shtëpitë e tyre. Home Care ka pasur ndikim pozitiv edhe në punësimin e stafit profesional, të cilët janë të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku përmes angazhimit në projekt kanë krijuar përvojat e tyre të para në punë.

1200 të moshuar, 130 persona me aftësi të kufizuara, kanë pranuar 45780 shërbime shëndetësore dhe sociale sipas konceptit të Home Care gjatë vitit 2020. Po ashtu, 82 persona janë përkrahur me shtretër, karroca, shetitore, ulëse, etj.

Partnerët: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komunat: Prizren, Ferizaj, Gjilan, Viti, Suharekë, Fushë Kosovë, Rahovec, Istog, Skënderaj, Obiliq, Drenas, Shtime

Mbështetja e shërbimeve Ambulatore

Përmes këtij angazhimi, respektivisht ofrimit të shërbimeve ambulatore, Caritas Kosova synon jo vetëm funksionalizimin e punkteve shëndetësore në lokacionet ku mungon shërbimi i tillë, por edhe ofrimin e shërbimeve për popullësinë apo shtresën më të varfër e cila ka qasje të kufizuar ose asnjëfare në shërbimet ambulatore. Kjo gjithashtu rrit edhe mobilitetin e vet përfituesve, duke rikthyer besimin në vlerat njerëzore të solidaritetit.

Ofrimi i shërbimeve të kombinuara shëndetësore dhe sociale, në ambulanta të ndryshme gjatë vitit 2020, përveq që ishte e nevojshme, u shëndrrua në një mision të vështirë por të arritshëm për Caritas Kosova për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19. Për dallim nga vitet tjera, në vitin 2020 pati një kërkesë të shtuar për shërbime shëndetësore dhe sociale të cilat ishin tema kryesore e shoqërisë, në kohën kur shëndeti mori vëmendjen kryesore.





Prandaj, si rezultat i shpalljes së situatës emergjente shëndetësore nga Qeveria e Kosovës, Caritas Kosova ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të gjitha aktivitetet shëndetësore dhe sociale të bëhen në koordinim me institucionet publike dhe sipas rekomandimeve dhe vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës.

Në kuadër të këtij angazhimi, Caritas Kosova ka mobilizuar tërë stafin shëndetësorë në 15 Komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Viti, Shtime, Suharekë, Rahovec, Istog, Skenderaj, Drenas, Obiliq dhe Fushë Kosovë. Në secilën komunë respektive, Caritas Kosova ka ofruar shërbime shëndetësore dhe sociale duke u munduar që të kontribuoj në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen nga infektimi me Covid-19 si pjesë e ekipeve emergjente komunale në luftën kundër Covid-19.

Gjatë vitit 2020, në kuadër të shërbimeve ambulatore, kemi ofruar mbi 1.35 milion shërbime shëndetësore dhe sociale.

Partnerët: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komunat: Prizren, Ferizaj, Gjilan, Viti, Suharekë, Fushë Kosovë, Rahovec, Istog, Skënderaj, Obiliq, Drenas, Shtime

C.I.K. Ambulanca Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë



Në kuadër të përkujdesit shëndetësor Caritas Kosova ka edhe ambulancën specialistike të mjekësisë familjare dhe ambulancën e stomatologjisë në Dubravë të Ferizajt. Kjo ambulancë funksionon në hapësirat e Qendrës Sociale Edukative 'Caritas Kosova' dhe ofron shërbime shëndetësore pa pagesë për banorët e fashatit Dubravë. Ambulanca është e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, ka staf profesional mjekësor si dhe pajisjet e nevojshme medicinale dhe prezenca e saj në këtë lokalitet është e një rëndësie të veçantë marrë parasysh nevojën e komunitetit si dhe rëndësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore sa më pranë tyre. Aktualisht Ambulanca funksionon me orarë të plotë dhe përveç shërbimeve shëndetësore luan një rol shumë të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve dhe ngritjen e vetëdijes së fëmijëve që frekuentojnë Qendrën mbi rëndësinë e parandalimit dhe trajtimit shëndetësor.

Në kuadër të Ambulancës Specialistike, gjatë vitit 2020, kemi ofruar shërbime shëndetësore dhe stomatologjike për të gjithë banorët e Dubravës. 4156 pacientë kanë pranuar shërbime pa pagesë.

Fusha strategjike:

Përmirësimi i pozitës sociale të
njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i
komunitetit për përfshirje dhe
kohezion social






Paqa dhe Diversiteti

Programi i Paqes dhe Diversitetit është projekt i cili është duke u zbatuar në Mitrovicë dhe ka synim kryesor arritjen e paqes, përfshirjes sociale të grupeve të cënuara si dhe promovimin e paqes ndëretnike. Ky projekt është zbatuar në vazhdimësi nga Caritas Kosova në bashkëpunim me Secours Catholique - Caritas France dhe me shumë partner lokal.

Në vitin 2020 ky projekt është fokusuar në tri komponente kryesore: përkrahjen në bujqësi, përkrahjen në aftësim dhe punësim si dhe në përkrahjen e ndërmarrësisë sociale.

Gjatë vitit 2020 kemi ofruar mbështetje konkrete për këto grupe të cënuara në sektorin e bujqësisë, ku 15 fermer janë trajnuar për bletari dhe po ashtu janë trajnuar në hartimin e planeve të tyre të biznesit. Tashmë 7 prej tyre kanë përgatitur planet bazike financiare.



PEACE & DIVERSITY



Nga projekti u është ofruar mbështetje edhe 5 punëkërkesve, që mbas identifikimit janë sistemuar në trajnime përkatëse në Qendrën Profesionale Diakonie DTC në Mitrovicë.

Përveç kësaj, projekti Paqa dhe Diversieti gjatë vitit 2020 ka identifikuar dhe përkrahur zhvillimin e dy ideve në fushën e ndërmarrësisë sociale. Njëra ide ishte ndërtimi i serës në bashkëpunim me Qendrën Burimore Nëna Terezë në Mitrovicë, ide kjo e cila është realizuar deri në një fazë të caktuar dhe idea tjetër me shoqatën e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara "Podrzi me" (Më përkrah) nga Mitrovica e Veriut e cila pritet të realizohet në vazhdim.

Bamirësia dhe Solidariteti



Që nga fillet e para të angazhimit të Caritas Kosova, asistencë sociale për familjet që jetojnë në varfëri ekstreme ka qenë një nga objektivat kryesore.

Gjatë vitit 2020 janë ndihmuar shumë familje me ndihma në ushqim dhe në veshmbathje, po ashtu një ndihmë e madhe ju ka dhënë edhe shoqatave të ndryshme të cilat punojnë me familjet e varfra. Në vitin 2020 janë shpërndarë 113 ton me ndihma humanitare. Gjatë vitit 2020 kemi shpërndarë mbi 50000 maska mbrojtëse si dhe 300 pako higjienike për të moshuarit.

Ky projekt paraqet një angazhim të vazhdueshëm të Caritas Kosova dhe është i mundur falë bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm, sidomos me Junge Leute Helfen nga Gjermania, të cilët na mbështesin me ndihma humanitare.

Partnerët: Junge Leute Helfen, Bamirësit





Drejtësia në Burgje

Burgu i ndryshon njerëzit në aspektin material, psikologjik dhe shpirtëror. Sidoqoftë, ndoshta aspekti më i dëmshëm psikologjik i burgut nuk është vet burgimi, por përkundrazi, është shkëputja nga miqtë, familja dhe bota e jashtme. Të burgosurit edhe pasi liroheni, e kanë të vështirë të përballen me traumën e përjetuar prapa grilave, ish-të burgosurit e kanë shumë të vështirë të ri-integrohen në shoqëri. Ata ndihen të shkëputur nga miqtë, familja, si dhe kolegët e tyre. Numri më i madh i ish-të burgosurve e kanë shumë të rëndë të përshtaten me të tjerët dhe të sigurojnë një vend pune.

Mjediseve të burgjeve në Kosovë, shpesh u mungojnë mjetet për të siguruar mbështetjen e duhur psikologjike dhe sociale. Kështu, Caritas Kosova përmes projektit “Nga parandalimi, nëpërmjet trajtimit dhe rehabilitimit deri në ri-integrim të suksesshëm” ka arritur të realizoj disa aktivitete më të burgosurit që kishin për qëllim trajtimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2020 konsistojnë në sesionet e art terapisë, sportit, trajnimeve në rrobaqepësi, floktari dhe punë praktike dhe janë realizuar në Qendrën Korrektuese, dhe Qendrën Edukuese Korrektuese, të dyja në Lipjan.

“Unë e kaloj kohën dhe ndjehem shumë mirë kur vjen trajneri i Artit siç e quajm ne Profa, me padurim e pres të fillojmë vizatimet “- është shprehur njëri nga të rinjt e burgosur.



Në kuadër të këtyre aktiviteteve dhe trajnimeve kanë qenë gjithsej 100 përfitues, duke përfshirë 80 të rinj dhe 20 gra të burgosura.

Perveç aktiviteteve dhe trajnimeve, projekti ka ndarë donacion edhe mjete dhe materiale pune për dy gra që kanë qenë pjesë e trajnimit të rrobaqepësisë e që pastaj janë liruar me kusht. Gjatë periudhës së monitorimit, gratë kanë treguar interes dhe gadishmëri të vazhdojnë punën e tyre si rrobaqepëse.

“Kam dëshirë të punoj në rrobaqepësi sepse edhe kur isha në burg, duke qepur e kaloja kohën me mirë, jam falenderuese për ndihmën tuaj” - deklarohet një përfituese.

Partnerët: Secours Catholique – Caritas France, Young in Prison





SOCIETIES

Projekti SOCIETIES, faza 2, ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve, përgjegjësinë dhe efektivitetin e OShC-ve në menaxhimin e iniciativave të përfshirjes sociale dhe de-institucionalizimit si dhe në promovimin dhe avokimin për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet e pranimit në Bashkimin Evropian. Të arriturat kryesore të këtij projekti gjatë vitit 2020 ishin: Përmbledhja e rezultateve për OshC-të në lidhje me situatën pandemike me Covid-19; Shpallja dhe distribuimi i granteve për OshC-të; Krijimi i grupeve avokuese; Kampanjat vedijesuese.

Periudha fillestare e projektit u karakterizua nga konfrontimi global me pandeminë Covid-19.

MBANI MENDJEN E KTHJELLËT



**10. TETOR
DITA BOTËRORE
E SHËNDETIT
MENDOR**

#mundtindodhëçdokujt

Përmbajja e këtij materiali nuk reflekton opinionin zyrtar të BE.
Përgjegjësia për informacionin dhe pamjet janë të Caritas Kosova.



Në muajt e parë të zbatimit të projektit në Kosovë, Caritas Kosova së bashku me partnerin e saj në vend filluan veprimet e tyre në hartëzimin e OSHC-ve në lidhje me aktivitetin i cili ishte përqendruar në studimin e ndikimit të Covid-19 mbi OSHC-të që punojnë me persona me aftësi të kufizuara. Në Kosovë, më shumë se 30 Organizata ishin pjesë e sondazhit. Të dhënat e sondazhit të marrë u zhvilluan më tej nga organizata Consorzio Comunitas Itali, dhe gjetjet kryesore nga studimi ishin në dispozicion në Flash Report i cili është i qashtëm për komunitetin publik dhe palët e tjera të interesit përmes kanaleve të ndryshme.

Dhënia e 8 granteve për OshC-të të cilët aplikuan në thirrjen për grante, ka lehtësuar në masë të madhe punën e tyre me përfituesit e synuar të projektit, sidomos kur kemi parasysh veshtirësitë e mëdha të organizatave në fjalë në sigurimin e fondeve në periudhën e pandemisë.

Shumica e aktiviteteve të parapara të zhvillohen në mënyrë fizike është dashur të organizohen përmes zgjidhjeve alternative siç janë platformat online të cilat megjithatë kanë rezultuar pozitive në kompletimin e aktiviteteve të parashikuara.

Fusha strategjike:

Krijimi i parakushteve për rritjen
e punësueshmërisë dhe të
vetëpunësimit



ELBA



ELBA (Emergency Labour in Balkans) është një iniciativë e projektuar për t'iu përgjigjur krizës ekonomike në Evropën Juglindore dhe pjesë të këtij projekti janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia Veriore. Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin publik si dhe sektorin privat, nga organizata fitimprurëse tek organizatat jo-fitimprurëse, nga territoret tek komunitetet, për të zhvilluar një model të ri ekonomik që përfshin njëri në nevojë si burim aktiv i shoqërisë.

Në shkurt të vitit 2020 në Torino, Itali, është mbajtur vizita studimore 3 ditore, ku Caritas Kosova ka marrë pjesë me 2 përfaqësues. Vizita studimore shërbeu për të parë dhe mësuar përvojat e ekonomisë sociale, vizita në ndërmarrjet sociale që funksionojnë mirë, si dhe u shkëmbyen përvojat në mes të pjesëmarrësve.

Shkaku i gjendjes së krijuar nga pandemia shumë vizita, takime dhe aktivitete janë shtyer për një afat tjetër. Përkundër kësaj, ne si Caritas Kosova jemi munduar, edhe pse në kushte të vështira, t'i mbështesim ndërmarrjet sociale të cilat janë përkrahur nga ELBA, në shkrimin e projekt propozimeve për aplikime në thirrje të ndryshme.

Po ashtu, janë organizuar disa Webinar me tematika të ndryshme gjatë tërë vitit 2020 në temat: Digitalisation and Digital Marketing; Co-Designing Social Impact; New Markets; Fundraising for the Social and Solidarity Economy dhe Individual Mentorship Sessions.

Partnerët: Caritas Italiana, Secours Catholique – Caritas France, Catholic Relief Services, Caritas Spain, Bashkimi Evropian – Erasmus+

Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës



Caritas Kosova është përqëndruar në fuqizimin dhe përkrahjen e të pa punëve drejt punësimit. Si rrjedhojë ky projekt është fokusuar në mënyrë të veçantë në mbështetjen e vetëpunësimit përmes trajnimit, mentorimit, rrjetëzimit, praktikës dhe mbështetjes materiale për gratë dhe të rinjtë e cenueshëm që kërkojnë një vend pune ose që janë të gatshëm për të filluar ose zhvilluar biznesin e tyre për gjenerimin e të ardhurave.

Kështu, gjatë vitit 2020, 25 të rinjë dhe gra kanë përfituar mjete pune nga skema e granteve në vlerë deri në 4,000€ si mbështetje për aktivitetet/bizneset e tyre të reja ose ato ekzistuese.

48 të rinj dhe gra kanë zhvilluar planin e tyre të biznesit, krahas kësaj janë krijuar 50 vende të reja të punës.





Të rinjtë dhe gratë janë mbështetur edhe me punë praktikë, gjithsej 23 të rinj dhe gra kanë përfunduar punën praktike një mujore, projekti ka bashkëpunuar me 22 kompani për përfshirjen e të rinjve dhe grave në skemën e praktikës.

Projekti ka ofruar edhe trajnime ku 95 përfitues morën çertifikatë profesionale, të njohura ndërkombëtarisht. Përmes projektit është organizuar edhe një vizitë studimore në Sombor, Serbi, ku gratë ndërmarrëse kanë fituar aftësi të reja në bletari, përpunimin e ushqimit, si dhe rritjen dhe shitjen e luleve. Caritas Kosova përmes projektit ka përkrahur në mënyrë financiare edhe 5 shoqata të grave dhe të rinjve, duke fuqizuar kështu edhe më shumë mbështetjen konkrete ndaj tyre.

“Po të mos ishte projekti une ende do të isha në skemën sociale, fal jush sot kam biznesin tim dhe siguroj të ardhurat të mjaftueshme për mua dhe familjen time”- Venera Kopili, robaqepëse, përfituese e skemës së granteve.

Partnerët: Bashkimi Evropian dhe Secours Catholique – Caritas France





YourJob

Projekti YourJob i Caritas Kosova është projekt që synon të përgatisë të rinjtë për tregun e punës. YourJob është duke u zbatuar në komunitat: Prizren, Gjakovë, Viti, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut dhe Kllokot.

Gjatë vitit 2020, në kuadër të projektit, kanë përfituar rreth 800 të rinj nga komunitat ku zbatohet projekti. Në këtë periudhë kemi sfiduar nga pandemia dhe siç dihet në kohë krizash, të rinjtë kanë predispozita që të parët të humbin punën e tyre. Tek të rinjtë e pa punësuar, Covid-19 ka shkaktuar pasoja sociale dhe materiale duke ndikuar që ata të përjetojnë përjashtim shoqëror, ankth dhe mungesë shprese për të ardhmen. Kjo gjendje ka ndikuar që stafi i projektit të bëhet edhe më kreativ në gjetjen e mundësive alternative për të vazhduar punën duke llogaritur që YourJob ishte mundësia dhe shpresa e vetme e punësimit për shumë të rinj.





Caritas Kosova në konsultim me partnerët e projektit, ka ndryshuar strategjinë e punë duke kaluar në platformat online. Kështu, gjatë periudhës së mbylljes mars-qershor 2020, janë realizuar 6 trajnime online në fushat që janë përzgjedhur nga të rinjtë. Kemi startuar me trajnimin në fushën e psikologjisë – aspekt shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e shëndetit mendor, sidomos në situatë të mbylljes totale. Pastaj kemi vazhduar me trajnimin në fushën e të drejtave të punëtorëve dhe mbrojtjes në punë, avokimin në institucione publike, shkathësitë në komunikim, sistemin e shitjes si dhe trajnimin në fushën e ndërmarrësisë. Trajnimet janë realizuar në bashkëpunim me profesionistë të fushave, duke përfshirë edhe profesor universitar. Nga këto 6 trajnime kanë përfituar rreth 150 të rinj.



Përkundër sfidave projekti ka arritur që të përkrah të rinjt në punësim, gjatë vitit 2020 janë mbështetur në punë praktike 50 të rinj, 80% e të cilëve kanë arritur që pas përfundimit të punës praktike të vazhdojnë marrëdhënien e rregullt të punës në po ato biznese. Falë mbështetjes së Caritas Kosova, ata sot janë pavarësuar në aspektin ekonomik dhe janë përgatitur profesionalisht për tregun e punës.

Me lirim të masave mbrojtëse për Covid-19, në kuadër të projektit është vazhduar mbështetja e të rinjve në trajnime profesionale, tre, gjashtë, dhe nëntë mujore. Saldimi, kuzhina, instalimet elektrike, teknologjia informative, etj. janë disa nga fushat në të cilat mbi 80 të rinj janë çertifikuar gjatë vitit 2020. Po ashtu, është me rëndësi të theksohet që edhe përmes trajnimeve të çertifikuara, mbi 50% e kandidatëve janë sistemuar në punë të rregullt, pas çertifikimit.

Në kuadër të projektit, është realizuar edhe faza e parë e ndarjes së granteve, duke përfshirë një cikël trajnimesh në ndërmarrësi. Ky proces ka përfunduar me përzgjedhjen e 7 të rinjve nga Prizreni, Gjakova, Mitrovica, Vitia dhe Kllokoti, të cilët janë përfitues të granteve dhe janë bërë ndërmarrës të rinj si rezultat i mbështetjes nga Caritas Kosova.

Krahas gjithë kësaj mbështetjeje konkrete, stafi i projektit YourJob ka ndihmuar përmes këshillimit dhe orientimi në karrierë, mbi 500 të rinj të cilët kanë vizituar zyret e YourJob gjatë vitit 2020.



PRAXIS

Zbatimi i projektit PRAXIS ka filluar më 1 shtator 2020 ku përqëndrimi i fazës fillestare ka qenë koordinimi i punës me të gjitha palët e interesit, sidomos kur kemi parasysh që PRAXIS është projekt ndërkufitar në mes të Kosovës dhe Malit të Zi dhe kërkon koordinim të shumë akterëve. Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe nga Catholic Relief Services kurse menaxhohet nga Ministria e Financave e Malit të Zi.

Që nga fillimi, PRAXIS ka qenë i sfiduar nga gjendja me pandeminë Covid-19. Por duke i respektuar masat anti-covid, gjatë vitit 2020, janë organizuar 13 takime informuese dhe 17 takime konsultative me palët e interesit, nga të dy shtetet. Këto takime targetuan të gjithë akterët kryesorë të projektit: qeveritë lokale komunale, qendrat e trajnimit, institucionet arsimore formale dhe joformale, përfaqësuesit e të rinjve dhe OSHC-të.

Më pas është organizuar ceremonia hapëse e projektit e cila u mbajt në Gjakovë, duke mbledhur akterë të ndryshëm, të rëndësishëm në fushën e synuar të projektit dhe partnerët në zbatim.





Aktivitetet kryesore të zbatuara janë: Trajnimi i këshilltarëve lokalë të karrierës për kualifikim të mëtutjeshëm; Botimi i gjashtë broshurave për orientimin në karrierë për grupe të ndryshme; Organizimi i tre seancave kolektive për udhëzime në karrierë; Organizimi i dy vizitave për zbulimin e vendeve të punës në ndërmarrjet për të rinjtë.

Arritjet kryesore të zbatimit të projektit ishin: Sigurimi i informacionit të plotë dhe të azhurnuar; Burimi ekzistues i informacionit dhe mjetet e krijuara për të rinjtë në internet; Analiza e sektorit të arsimit zyrtar dhe joformal; Paketa e zbatuar e aktivitetit u ofron të rinjve dhe familjeve të tyre për të nxjerrë vendime të informuara në lidhje me orientimin e tyre profesional dhe të ardhmen.

Përveç kësaj, ekipi i projektit ka krijuar sistem referimi për të orientuar grupet e synuara drejt iniciativave të ndryshme që mbështesin orientimin e të rinjve dhe punësimin, si në Kosovë ashtu edhe në Mal të Zi.

Partnerët: Bashkimi Evropian dhe Catholic Relief Services



Fusha strategjike:

Realizimi i së drejtës në edukim
dhe arsim cilësor





Kopshti Engujt

Në kuadër të programeve dhe projekteve të veçanta që zbaton Caritas Kosova, edukimi parafillor dhe menaxhimi i kopshteve për fëmijë është objektivë e rëndësishme e Caritas Kosova, prandaj edhe gjatë vitit 2020 Caritas Kosova ka menaxhuar me sukses, përkundër situatës pandemike, kopshtin e fëmijëve Engujt me qëllim të ofrimit të shërbimeve edukuese kualitative të kujdesit ditor për fëmijët të cilët kanë nevojë për mirëqenie dhe kanë nevojë që edukimi dhe socializimi i tyre të bëhet me një standard të lartë të edukimit dhe profesionalizmit

Mbyllja e institucioneve edukativo-arsimore, në mars 2020, për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së Covid-19, ka ndikuar në funksionimin normal të Kopshtit dukë vështirësuar punën me fëmijët. Pavarësisht kësaj, në periudhën prill-maj 2020, kemi ofruar edukim online për tu rikthyer në punë normale në qershor 2020.





Kopshti Engjujt, gjatë këtij viti, ka ofruar shërbimet e kujdesit për 230 fëmijë të moshave 06 muaj deri në 6 vjeç. Kopshti Engjujt është i licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ka lokacion shumë të përshtatshëm, hapësira gjelbëruese dhe objekt të modeluar posaçërisht për botën e këndshme të fëmijëve. Ne krijojmë avantazh në realizimin e planprogramit përmes aktiviteteve të cilat kërkojnë hapsirë adekuate, duke përfshirë këtu edhe hapsirat për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Partner: Komuna e Ferizajt



My Right – Qendra e Edukimit të Hershëm



Projekti My Right/E Drejta Ime ka në fokus fëmijët me aftësi të kufizuar, prindërit e tyre si dhe institucionet arsimore lokale. Ky projekt ka dy komponente kryesore në vetvete:

- Edukimin e Hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuar/Qendra e Edukimit të hershem për fëmijët 0-5 vjeç
- Gjithpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin e rregullt shkollor





Gjatë periudhës një vjeçare të zbatimit, projekti ka arritur që të ofroj në Qendër shërbime të edukimit të hershëm për 41 fëmijë me aftësi të kufizuar. Gjatë kësaj kohe, për fëmijët që kanë arritur moshën shkollore, është arritur që të krijohet plani i transferimit të 35 fëmijëve nga Qendra në shkollat fillore përkatëse.

Në vitin 2020, për shkak të Covid-19, jemi përballur edhe me sfidën e mësimit në distancë, që ka qenë mjaftë dekurajuese për fëmijet me aftësi të kufizuar të cilët nuk kishin mundësi të ishin prezent në Qendër dhe të takonin bashkëmoshatarët. Përkundër sfidave, është arritur që mësimi të realizohet në platforma online dhe falë bashkëpunimit me prindërit dhe familjarët kemi arritur të përfundojmë me sukses procesin mësimor.

Partnerët: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Caritas Austria, Komuna e Prizrenit

Përfshirja Sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian



Caritas Kosova punon intenzivisht në zhvillimin e projekteve për të përkrahur përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë socio-ekonomike, arsimore dhe kulturore të këtyre komuniteteve, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e saja në katër komponentë kryesorë, në Edukim, Kulturë, Shëndetësi dhe Asistencë Sociale. Përkundër intervenimit në shumë fusha këto komunitete vazhdojnë të përballen me probleme të mëdha, sidomos me papunësinë, mos përfshirjen, segregimin, infrastrukturën e pakët, etj.



Qendra Sociale-Edukative "Caritas Kosova" – Dubravë, Ferizaj



Në Qendrën Sociale dhe Edukative të Caritas Kosova në Dubravë të komunës së Ferizajt, gjatë vitit 2020 janë ofruar shërbime të ndryshme për komunitetet që jetojnë aty, në total Qendra numroi 252 nxënës në të gjitha nivelet, 30 fëmijë ishin përfitues të mësimit parashkollor nga mosha 4 deri 6 vjeç, shërbime për mësim plotësues pranuan 140 nxënës të klasave I – V dhe 82 nxënës të klasave VI - IX. Përveç mësimi të rregullt, në Qendër janë mbajtur edhe kurse të teknologjisë informative për 150 nxënës të moshës 9 deri 15. Përgjatë vitit 2020 është punuar edhe në hartimin e planprogramit për mësimin plotësues për nivelet 0 dhe 1 duke u bazuar në kurrikulën e Ministrisë së Arsimit.

Në kuadër të Qendrës është edhe C.I.K. Ambulanca Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë e cila ofron shërbime shëndetësore për qytetarët e Dubravës.





Në Qendër është ofruar edhe asistencë sociale përmes ndihmave humanitare në ushqim dhe veshmbathje, sidomos kur kemi parasysh që për shkak të pandemisë me Covid-19, nevoja për këtë asistencë ishte tejet e madhe. Përfitues direk të kësaj mbështetje ishin 957 banorë të Dubravës.

Gjatë vitit 2020 po ashtu janë organizuar aktivitete psiko-sociale dhe kampanja vetëdijesuese. Në muajin tetor është organizuar një trajnim një ditor me të rinjtë e komuniteteve, si shënim i nisjes së fushatës kundër trafikimit me njerëz, si dhe rritja e vetëdijesimit për mbrojtjen nga Covid-19. Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Gjithashtu, është shënuar edhe fushata për Kancerin e Gjirit ku përmes një ligjërata sensibilizuese për këtë sëmundje, gratë e Dubravës përfituan informacione në lidhje me njohjen e kësaj sëmundje, dallimin e shenjave të hershme, metodat e kontrollit, ndikimin nga faktorët trashëgues si dhe masat parandaluese.



Qendra Sociale-Edukative "Caritas Kosova" – Lagja Ali Ibra, Gjakovë



Caritas Kosova punon vazhdimisht në zbatimin e projekteve që përkrahin përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë tonë, rëndësi të veçantë i kushtohet edukimit të fëmijëve dhe përmirësimit të mirëqenies së tyre sociale.

Caritas Kosova në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës ka vazhduar përkrahjen e komunitetit Egjiptian në lagjen Ali Ibra në Gjakovë. Edhe përmes këtij angazhimi Caritas Kosova synon që të krijoj më shumë mundësi për përfshirje sociale, sidomos për fëmijët e këtij komunitetit, përmes aktiviteteve të ndryshme në fushën e edukimit, kulturës, sportit, etj.





Gjatë vitit 2020, në këtë Qendër, janë ofruar shërbime edukative dhe aktivitete psiko-sociale për fëmijët e moshës 4 – 18 vjeç. 140 fëmijë kanë pranuar në baza ditore shërbime në kuadër të mësimin plotësues. 50 fëmijë nga moshë 4 deri në 6 vjeç kanë ndjekur edukimin parashkollor, ndërsa mësimin shtesë e kanë ndjekur 75 fëmijë të shkollave fillore, ndërsa 15 të tjerë kanë marrë pjesë në aktivitete psiko-sociale. Po ashtu, gjatë kësaj kohe kemi zhvilluar edhe kampanja të ndryshme vetëdijesuese në lidhje me çështjet e arsimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë.

Në kuadër të Qendrës janë ofruar edhe shërbime shëndetësore si pjesë e projektit “Home Care” ku përgjatë vitit 2020 kanë pranuar shërbime shëndetësore 104 të moshuar të komunitetit Egjiptian në lagjen Ali Ibra në Gjakovë.

Partner: Komuna e Gjakovës



Mbështetja e përfshirjes sociale të fëmijëve nga Roma Mahalla, Mitrovicë



Përmes këtij projekti, prindërit e fëmijëve rom janë të vetëdijshëm për rëndësinë e përfshirjes sociale dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe në mënyrë domethënëse shfrytëzojnë të drejtat për akses dhe pjesëmarrje në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Përmes metodologjisë Portage të zbatuar nga stafi i projektit, 80% e fëmijëve rom kanë demonstruar përmirësim të sjelljeve shoqërore dhe aspektet tjera të zhvillimit. Po ashtu, 80% e fëmijëve kanë përmirësuar kushtet e tyre shëndetësore duke përdorur këshillimin për nënën dhe fëmijën dhe shërbimin e rregullt të vaksinimit.

Në vijim janë disa rezultate konkrete të projektit: Më shumë se 100 fëmijë rom përfituan nga organizimi i punëtorive të ndryshme. Rreth 150 prindër morën pjesë në mënyrë aktive në punëtorinë me fëmijë.





Rreth 150 fëmijë nga komuniteti i gjerë dhe fëmijë me aftësi të kufizuar morën pjesë në punëtori gjithëpërfshirëse të krijimtarisë. Më shumë se 50 takime avokimi janë organizuar gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

Gjatë periudhës së pandemisë, gjatë vitit 2020, janë organizuar shumë takime koordinuese dhe kanë rezultuar të suksesshme me qenë se në bashkëpunim me UNICEF janë shpërndarë më shumë se 1500 pako higjienike për familjet në nevojë si dhe më shumë se 400 pako me material didaktik për fëmijët e Roma Mahallës.

Gjithashtu aktivitetet avokuse kanë rezultuar të suksesshme sepse janë përmirësuar kushtet teknike të mësimit në distancë duke shpërndarë 12 pajisje elektronike tek fëmijët më të cënueshëm që kanë ndjekur rregullisht klasat online. Më shumë se 100 familje janë vizituar nga psikologët e angazhuar në projekt duke siguruar lloje të ndryshme të mbështetjes për anëtarët e familjes: si të veprohet gjatë pandemisë me Covid-19, lloje të ndryshme të ndihmës psiko-sociale dhe seancave të këshillimit, si dhe janë siguruar informacione për hartën e nevojave emergjente.

Fusha strategjike:

Ndihma në situatat e fatkeqësive
natyrore dhe të konflikteve



ABC EUAV – Shoqërimi dhe ndërtimi i kapaciteteve



Projekti ABC-EUAV zbatohet nga konsorciumi i nëntë organizatave të Caritas-eve nacionale në vendet e Evropës Lindore dhe Jug-Lindore me objektivin e përgjithshëm të rritjes së kapaciteteve ekzistuese organizative në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat dhe gatishmërisë së emergjencave, si dhe krijimin e sistemeve efektive dhe efikase të menaxhimit vullnetar. Ky projekt udhëhiqet nga aplikanti kryesor Caritas Europa. Projekti synon të krijojë mënyrat më efikase për të ndarë njohuritë rreth EUAV (metodologjitë, mjetet dhe praktikat më të mira). Partnerët mësojnë nga njëri-tjetri dhe mbështesin njëri-tjetrin në zhvillimin e procedurave të nevojshme për të përbushur kërkesat e EUAV dhe për të ndërtuar kapacitetet organizative.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2020 ishin: Takimi hyrës lidhur me fillimin e projektit; Trajnimet mbi menaxhimin e vullnetrëve; Replikimi i trajnimeve me personelin e Caritas Kosova; Takimet e rregullta online me akterët në rajon dhe më gjerë; Përgatiditja e materialit mbi DRR (zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat); Planet nacionale të emergjencave; Planet përgaditore për emergjenca.

EU Aid Volunteers

We Care, We Act





Projekti ka startuar në fillim të muajit Shkurt 2020, pra në prag të konfrontimit global me pandeminë Covid-19. Në muajt e parë të zbatimit të projektit në Kosovë, Caritas Kosova së bashku me partnerët e saj filluan të diskutojnë për mundësitë e riorganizimit të aktiviteteve të parapara në projekt. Ashtu si edhe projektet tjera, edhe ky projekt u sfidua shumë nga pandemia kur kemi parasysh që në përmbajtje ka trajnimet me tema të ndryshme. Këto aktivitete fillimisht u anuluan për tu organizuar më vonë përmes platformave online.

Partner: Bashkimi Evropian



Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19



Caritas Kosova ka luajtur rol të rëndësishëm në orfimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për kategoritë e cenueshme, sidomos për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar, edhe gjatë periudhës së pandemisë.

Në nëntor të vitit 2020 ka filluar zbatimi i këtij projekti që në përgjithësi ka për qëllim që të kontribuojë në fuqizimin e qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar në Ballkanin Perëndimor gjatë pandemisë me Covid-19 dhe katastrofave të ardhshme. Në mënyrë më specifike ky projekt synon që personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuar, OShC-të dhe organizatat tjera lokale, të janë më të aftë për të përballuar situatën me Covid-19 në Kosovë.


Ky projekt regjional zbatohet në Kosovë, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi. Në Kosovë projekti zbatohet në Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Mitrovicë dhe Viti.

Partnerët: Bashkimi Evropian, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Red Cross-Serbi

Buxheti Vjetor

Buxheti Vjetor 2020	4,468,298 €
Home Care/Përkujdesi Shtëpiak & Mbështetja e Shërbimeve Ambulantore	3,206,209 €
Paqa dhe Diversiteti	22,111 €
Bamirësia dhe Solidariteti	3,000 €
SOCIETIES	44 132 €
ELBA	8,196 €
Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës	114,691 €
YourJob	269,954 €
PRAXIS	157 786 €
Kopshti Engjujt	319 832 €
My Right - Qendra e Edukimit të Hershëm	70,918 €
Përfshirja sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	158,795 €
ABC EUAV - Shoqërimi dhe ndërtimi i kapaciteteve	18,231 €
ODSS	14,482 €
Tjera	59,961 €

Përqindja sipas projekteve



Home Care/Përkujdesi Shtëpiak & Mbështetja e Shërbimeve Ambulatore

Paqa dhe Diversiteti

Bamirësia dhe Solidariteti

SOCIETIES

ELBA

Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës

YourJob

PRAXIS

Kopshti Engjujt


My Right - Qendra e Edukimit të Hershëm

Përfshirja sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

ABC EUAV - Shoqërimi dhe ndërtimi i kapaciteteve

ODSS

Përqindja sipas Donatorëve



Rrjeti Caritas

Bashkimi Evropian

Institucionet dhe Organizatat ndërkombëtare

Institucionet Qendrore dhe Lokale

Tjera